



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 318 Prot.
27.02.2023

Tiranë, më

V E N D I M

Nr. 31 , datë 27.02.2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,² mori në shqyrtim ankesën me nr.135 regj, datë 12.09.2022, të paraqitur nga Fondacioni “Së bashku”³, përfaqësuar nga S. L, Drejtore Ekzekutive, kundër Bashkisë së Tiranës, me pretendimin për diskriminim të personave me aftësi të kufizuara për mosgarantimin e aksesueshmërisë në ishullin e kalimit në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese parashtron se, që prej muajit prill 2022 është duke zbatuar nismën “Të rinjtë për gjithëpërfshirjen” në Bashkitë Kamëz , Vorë dhe Kavajë.

Në këtë kuadër, është ngritur grupi i të rinjve aktivist, të cilët nga inspektimi në terren, kanë konstatuar disa problematika për garantimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në ishullin e kalimit në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri ose me akronimin KMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

³ Në vijim do t'i referohemi “Pala ankuese”

Pala ankuese pretendon se ky ishull nuk është konform standardeve teknike dhe se është i rrezikshëm nëse përdoret nga personat me aftësi të kufizuara. Semafori nuk është akustik për personat që nuk dëgjojnë, si dhe nuk ka shirita me relief për personat që nuk shikojnë.

Subjekti ankues shprehet se ishulli i kalimit duhet të jetë plotësisht i sheshtë dhe jo në formë gunge, si dhe pretendon se ky investim bie ndesh me parashikimet e VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”* dhe VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Për shfrytëzimin e haësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”*.

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar nga Bashkia Tiranë, për mosgarantimin e aksesueshmërisë në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “b”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cënohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.”*

Nga aktet e administruara rezulton se, Fondacioni “Së bashku” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur, Fondacioni “Së bashku” nuk pretendon se është cënuar në interesin e tij të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara për mosgarantimin e aksesueshmërisë në ishullin e kalimit në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Fondacioni “Së bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’u përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a publikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore të LMD-së, Komisioneri shqyrtoi çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1240/1 prot., datë 14.09.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Tiranë, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.
2. Bashkia Tiranë nuk iu përgjigj kërkesës sipërcituar të Komisionerit. KMD në vijim nëpërmjet shkresës me nr. 1240/2 prot., datë 03.11.2022 iu drejtua sërish Bashkisë, duke i kërkuar informacionin dhe dokumentacionin përkatës.
3. Duke mos patur asnjë përgjigje nga Bashkia, bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”*, si dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr. 1240/3 prot., datë 23.11.2022, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore.
4. Me shkresën nr. 31830/3 prot., datë 06.12.2022⁴, Bashkia Tiranë ktheu si përgjigje në lidhje me kërkesën e mësipërme të dërguar nga Komisioneri, shkresën që Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale i ka dërguar për kompetencë drejtorive të tjera po

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1243/11 prot., datë 09.12.2022.

brenda kësaj Bashkie (Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, Drejtorisë së Transportit dhe Trafikut Rrugor dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik). Ndër të tjera citohet se, përfaqësues nga Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor dhe Shërbimeve të Integruara do të marrin pjesë në seancën dëgjimore pranë Zyrës së KMD-së.

Seanca dëgjimore u zhvillua datën 09.12.2022, ora 10:00, me pjesëmarrjen e Fondacionit “Së bashku”, përfaqësuar nga Drejtoria Ekzekutive, S. L, dhe Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga Përgjegjësi i Sektorit/Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor dhe Shërbimeve të Integruara, E.H, Përgjegjësjë e Sektorit/Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, F.H, dhe Specialistja e Drejtorisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shërbimeve të Integruara, M. L.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Fondacionit “Së bashku”, deklaroi se u qëndronte pretendimeve për diskriminim nga ana e Bashkisë Tiranë, por për ata si palë ankuese, ishte e rëndësishme të rregullohej situata para se Komisioneri të shprehej me një vendim dhe nëse kjo gjë arrihej ata do të tërhiqeshin nga ankesa pasi do ta konsideronin të arritur qëllimin për të cilin ishin ankuar.

Përfaqësuesit e Bashkisë nuk vunë në dispozicion informacion në lidhje me hartimin e planit të masave nga ana e kësaj Bashkie, me qëllim mënjanimin e pengesave për personat me aftësi të kufizuara, sipas detyrimit të përcaktuar në VKM nr.1074, datë 23.12.2015 “*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*” (në vijim VKM nr.1074/2015). Ata u shprehën se në lidhje me këtë problematikë do të dërgonin informacionin në vijim të seancës dëgjimore, pasi çështjen do ta referonin pranë strukturave kompetente pranë institucionit të tyre.

Bazuar në pikën 9, të nenit 33, të LMD, përcaktohet se:

“9. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa.” Bazuar në këtë kompetencë ligjore, si dhe duke vlerësuar qëndrimin e palëve gjatë seancës dëgjimore, Komisioneri i'u parashtroi palëve nëse ata mund të arrinin një marrëveshje me pajtim në lidhje me problematikën e parashtruar dhe qëndrimet e tyre në rast të arritjes së një marrëveshje t'ia komunikonin Komisionerit.

Në vijim të seancës dëgjimore, Bashkia nuk depozitoi pranë Komisionerit asnjë informacion në lidhje me çështjet e mësipërme që të provonte se kishte vullnetin apo të konkretizonte me veprime se po ndërmerre apo do të ndërmerre brenda një afati të arsyeshëm kohor masat e nevojshme për rregullimin e situatës.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në situatën e konstatuar, provat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar.

Pala ankuese në çështjen objekt shqyrtimi është një organizatë jofitimprurëse, e cila ushtron veprimtarinë e saj, ndër të tjera, dhe në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Pala ankuese pretendon se ishulli i kalimit në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, nuk është konform standardeve teknike dhe ligjore të aksesueshmërisë dhe se është i rrezikshëm nëse përdoret nga persoant me aftësi të kufizuara. Semafori nuk është akustik për personat që nuk dëgjojnë, nuk ka shirita me relief për personat që nuk shikojnë, dhe se ishulli i kalimit duhet të jetë plotësisht i sheshtë dhe jo në formë gunge, në mënyrë që të jetë i aksesueshëm dhe i sigurtë për personat paraplegjikë e tetraplegjikë. Bashkia Tiranë është përgjegjëse për menaxhimin e rregullimin e situatës sipërcituar, pasi kjo pjesë e rrugës për të cilën pretendohet, është në territorin e nën administrimit të saj. Pala ankuese ka pretenduar se, lidhur me sa më sipër, Bashkia me mosveprimet e saj ka diskriminuar personat me aftësi të kufizuara.

Për të marrë informacion dhe për të shqyrtuar pretendimet e ngritura nga pala ankuese, Komisioneri i’u drejtuar Bashkisë Tiranë, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa objekt shqyrtimi, duke kërkuar informacion nëse ishulli i kalimit në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”/Bashkia Tiranë, plotëson standardet e aksesueshmërisë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimit të ankesës dhe qëndrimit të mbajtur nga Bashkia, rezultoi se pretendimi i ngritur nga Fondacioni “Së bashku” qëndron, dhe se ishulli i kalimit në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, nuk është konform standardeve teknike dhe ligjore të aksesueshmërisë për PAK. Ishulli i kalimit të këmbësorëve është në formë gunge dhe jo plotësisht i sheshtë, nuk ka shirita me relief për personat që nuk shikojnë. Gjithashtu semafori i vendosur nuk është akustik, që t’u shërbente kësaj kategorie personash.

Gjatë seancës dëgjimore e në komunikimin me KMD, përfaqësuesit e Bashkisë deklaruan se do të merrnin masa për të deleguar e bashkëpunuar me strukturat përgjegjëse pranë Bashkisë Tiranë, të cilat kishin dhe tagrin për menaxhimin e zgjidhjen e problematikës së ngritur nga ana e Fondacionit.

Kuadri ligjor i zbatueshëm.

Detyrimi i institucioneve publike shtetërore për të siguruar aksesueshmërinë është një detyrim *ex ante*.

Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”*, parashikon gjithë-përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara.

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Ligji nr. 93/2014, i ndryshuar, ka për qëllim:

- “a) të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes;*
- a) të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri”.*

Në kuptim të këtij ligji. “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve.

Parimet bazë të këtij ligji janë:

- a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë;
- b) ç) garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimi të pengesave të të gjitha llojeve.

Jetesa e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”* parashikohet se:

“Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës”.

Sipas shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.93/2014, parashikohet: *“ 2. Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës;...”*

Në nenin 5, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet se:

“1. Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.”

Sipas nenit 6, të ligjit nr. 93/2014, *jetesa e pavarur*, mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave.

VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”*, ka në objekt të saj përcakimin e kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.

Fusha e aplikimit të saj shtrihet në: *“...të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t'i nënshtrohen rikonstruksionit; ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes; ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik”*.

Neni 3, i kësaj VKM, ka përcaktuar se “barrierat arkitektonike” janë:

“1...a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar të përhershme ose të përkohshme;

2. Personat me aftësi të kufizuara (PAK) janë individët, me kufizim të aftësive në lëvizje, si pasojë e dëmtimeve fizike, mendore, intelektuale apo shqisore, të cilët në ndëreveprim me barrierat të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.

6. Mjet ndihmës për lëvizje është karroca për PAK, shkopi, paterica dhe mjete të tjera ndihmëse për ecje;

8. Eliminimi i barrierave është rezultat i aplikimit të zgjedhjes teknike në projektim dhe ndërtim të objektit me të cilat PAK-ja siguron lëvizjen pa pengesë, qëndrimin dhe kryerjen e punëve në to në të njëjtin nivel sikurse personat e tjerë.

9. Elementet e eliminimit të barrierave janë pjesë të objekteve ndërtimore ose pajisje, të cilat sigurojnë eliminimin e barrierave, të përcaktuara me këtë rregullore. Këto elemente ose pajisje janë: rampa, shkallë, ashensor, platforma vertikale ngritëse, platforma të pjerrëta lëvizëse palosëse, detaje në hapësirat hyrëse, doreza e derës dhe dritares, pulti, tabela e shpalljeve, plani orientues për lëvizje në ndërtesë, semafori, pajisje komunikimi, hapësira, banja, kuzhine, dhoma, klasa, ambiente pune, banimi/apartamenti, kafeneja, restoranti, gardëroba, kabina dushi, pishina, vendet në tribuna, kabina telefonike, tekstofoni, bankomati,

instalimet elektrike, stacioni dhe peroni, vend parkingu, sipërfaqja publike për këmbësor, kalimi për këmbësor, ishulli për këmbësorë dhe udhëkryqi

10. Elementet e detyrueshëm për eliminimin e barrierave janë elementet për projektim dhe ndërtim me anë të të cilave përcaktohet madhësia, vetitë, instalimet dhe pajisjet e tjera të ndërtesës për sigurimin e eliminimit të pengesave në lëvizje, qëndrim dhe punë të PAK-së, në të njëjtin nivel me personat tjerë.

11. Shenjat dalluese janë shenjat me të cilat përcaktohen elementet detyruese për përshtatje.

....13. Lajmërimi me sinjalizime të dritës është lajmërimi dhe paralajmërimi për personat që nuk dëgjojnë dhe ata me dëgjim të dobët me ndihmën e sinjalizimit të dritës.

14. Lajmërimi zanor është lajmërimi dhe paralajmërimi nëpërmjet zërit për personat që nuk shohin dhe/ose kanë shikim të dobët.

15. Sinjalizimi zanor është sinjalizimi i cili ndihmon personat që nuk shohin dhe/ose me shikim të dobësuar për orientim në hapësirë.

....19. Përpunimi relievior është përpunimi përfundimtar me reliev i sipërfaqes së ecjes.

20. Vija relievore drejtuese është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes e dedikuar për drejtim të lëvizjes së personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar, e cila në fund të rrugës dhe në vendin e ndërrimit të drejtimit të lëvizjes përcakton atë me ndërrimin e strukturës relievore me gjërsi së paku 40 cm.

21. Vija relievore paralajmëruese është përpunim me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila vendoset me qëllim të paralajmërimit të personave që nuk shohin dhe/ose me shikim të dobësuar për rrezikun nga komunikacioni.

22. Fusha relievore paralajmëruese është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila shërben për paralajmërim të personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar të ndryshimit të nivelit të lëvizjes.

23. Element tipik është element i dedikuar për ndarjen e sipërfaqes publike të këmbësorëve nga korsitë e automjeteve, korsitë e biçikletave dhe/ose parkingjet, e cila mund të jetë i formave dhe objekteve të ndryshme si: vazo për lule, mure, stola dhe të ngjashme.

24. Sipërfaqja publike e këmbësoreve janë shtegje, sheshe, mbikalime, nënkalime, ura për këmbësorë dhe të ngjashme.

25. Sipërfaqe me reliev e kalimit është shenjë relievore e cila personave që nuk shohin dhe/ose me shikim të dobësuar i'u afron informacion për gjatësinë dhe llojin e kalimit të këmbësoreve përtej kalimit të automjeteve”.

Në nenet ⁷, ⁸, ²⁷, ²⁸ të kësaj VKM-je, përcaktohet specifikisht se:

“7. 1. Për vendkalimet e këmbësorëve ngjitur me hapësirat e rezervuara për automjetet, rregullat e dhëna në pikat 2.2 të nenit 4 dhe 8 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje, vlejnjë karakteristikat e shtrimit dhe të bashkimit të dysHEMEVE të trotuarit me hapësirat e rezervuara

⁵Trotuaret

⁶Vendkalimet për këmbësorët

⁷Sipërfaqja publike

⁸Semafori

për makinat.

2. Disniveli, mes sipërfaqes së trotuarit dhe rrugëve pranë tyre nuk duhet të kaloj 5 cm.

3. Gjerësia e trotuareve të realizuar në ndërhyrjet e reja të urbanizmit duhet të jetë e tillë, që të mundësojë shfrytëzimin dhe nga ana e personave në karrige me rrota, duke patur parasysh edhe pengesat e krijuara nga shtyllat e ndriçimit publik, sinjalistika rrugore dhe nga çdo element tjetër që mund të zvogëlojë gjërësinë e përshkueshme të tyre, jo më pak se 1.2 m.

8.1. Në rrugët me fluks të lartë trafiku, vendkalimet për këmbësorë duhet të jenë të ndriçuara në orët e errësirës ose të rënies së fluksit të dritës në atë të lejuar.

2. Fundi i rrugës, në afërsi të vendkalimeve për këmbësorët, bëhet i dallueshëm nëpërmjet ashpërsimit të krijuar mbi sipërfaqen e rrugës, pengesave të vendosura mbi rrugë me qëllim sinjalizimin e domosdoshmërisë për uljen e shpejtësisë.

3. Paltformat e shpëtimit duhet të jenë të arritëshme për personat në karrige me rrota.

4. Semaforët, të instaluar rishtas ose që janë zëvendësuar, duhet të jenë të pajisur me lajmërues akustik, që sinjalizojnë kohën kur kalimi është i lirë, për personat që nuk shohin edhe për ata që lëvizin ngadalë, aty ku është e nevojshme me komanda manuale të arritshme për të lejuar kohën e mjaftueshme për kalimin e rrugës.

27. 1. Sipërfaqja publike - rruga për këmbësor duhet të jetë:

- i ngritur në krahasim me borduren së paku 3 cm ose i ndarë me vijë relievore paralajmëruese, e nëse është në nivel të shiritit atëhere ndahet me sipërfaqe rrethore me diametër jo më të vogël se 150 cm;

- i lidhur me sipërfaqet e tjera publike pa pengesë.

2. Ndryshimet e nivelit të sipërfaqeve publike – e rrugëve janë të lidhura me njeri tjetrin me elemente përkatës pershtatje për ndryshim të lartësive. Ato që lidhen me ashensorin e përshtatur ose me platformën ngritëse vertikale, detyrimisht duhet të jenë të lidhura me shkallët e përshtatura.

3. Të gjitha pajisjet komunale (banka, tavolina, shenja, shtylla ndriçuese, shportë, mbajtës për biçikletë, panele për reklama dhe të ngjashme) vendosen pranë skajit të sipërfaqes publike – shtegu për këmbësorë, në mënyrë që të mos pengoj personat që nuk shikojnë dhe me shikim të dobësuar.

4. Të gjitha ekspozimet në murin e ndërtesës pranë sipërfaqes publike për këmbësorë, si dhe ekspozimet e tjera në këto mure të cilat ndodhen në lartësinë 70 deri 220 cm dhe të dalura më shumë se 10 cm, duhet të jenë të realizuara në tërë gjatësinë e tyre deri te sipërfaqja për këmbësorë ose të jenë të shënuara në mënyrë që sipërfaqja e këmbësorëve nën to të jetë e ngritur minimumi 3 cm në krahasim me nivelin rrethues.

5. Kur së bashku me sipërfaqet publike të këmbësorëve parashikohet rruga e biçikletave ose parkingu, është e nevojshme realizimi i kufizimit prej sipërfaqeve publike të këmbësorëve me të paktën 3 cm, ose sipërfaqe të gjelbër apo elementë tipike edhe të ngjashëm.

28. Semafori duhet të plotësoj këto kushte:

- planin relievor i kalimit për në semafor i cili ndodhet në kalimin e rrugës me më shumë se dy korsi të qarkullimit në një drejtim;
- sinjalizimin zanor, i cili ndodhet në zonat ku kryesisht qëndrojnë personat që nuk shikojnë dhe me shikim të dobësuar;
- sinjalizimi zanor i vendosur në semafor të një drejtimi qarkullues i cili nuk përputhet me sinjalizimin zanor të vendosur në semaforin e drejtimit tjetër qarkullues, te semaforët në udhëkryq;
- sinjalizimin zanor i vendosur në semafor, i cili lajmëron vetëm ndërrimin e dritës në semafor;
- shpërndarsin e zërit të sinjalizimit zanor i vendosur në semafor, i cili lajmëron personat që nuk shikojnë ose me shikim të dobësuar të cilët kalojnë rrugën.

3.1 Rrugët

.....Ishulli i këmbësorëve duhet të mundësoj përmbushjen e këtyre kushteve:

- në rastet kur ishulli i këmbësorëve ndodhet në nivel me rrugën ose niveli i tyre në vendkalim bëhet i njëjtë me nivelin e rrugës, atëherë 15 cm nga fillimi dhe 15 cm nga fundi shënohet vija relievore paralajmëruese me gravurë normal në drejtim të lëvizjes, me gjerësi jo më e vogël se 40 cm, sipas paraqitjes në fig. 38 të shtojcës B të kësaj rregulloreje;
- në raste kur ishulli i këmbësorëve është i ngritur në krahasim me nivelin e rrugës, kalimi nga rruga në ishullin e këmbësorëve realizohet me pjerrtësi sipas fig. 39 të shtojcës B të kësaj rregulloreje;

Udhëkryqi i cili ndodhet në zonat e vendbanimeve ku banojnë persona që nuk shikojnë ose me shikim të dobësuar, vendkalimi për këmbësor duhet të ketë semaforin e përshtatur me sinjalizim zanor dhe vijat relievore drejtuese. Vija relievore paralajmëruese realizohet deri te skaji i pjerrtësisë së kalimit në gjatësi jo më të vogël se 110 cm.

-Kur në udhëkryq nuk mund të evitohen pengesat në nivel të njëjtë, realizohen nënkalime ose mbikalime me aplikimin e elementeve përshtatës për arritjen në nivele me lartësi të ndryshme sipas dispozitave të kësaj rregulloreje”.

Për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore, Këshilli i Ministrave, ka miratuar vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohej pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

Sipas këtij vendimi, janë pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c)

mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar .

Sipas pikës 2, të Kreut 2, të VKM nr. 1074/2015, çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në Vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim VKM nr. 1503/2008/Rregullorja). Ndër të tjera, në këtë rregullore parashikohet sa më poshtë vijon:

“Pjesa I

Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike .

Kreu I

Të përgjithshme

Neni 1

Objekti, qëllimi dhe fusha e aplikimit

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”.

2. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.

3. Fusha e aplikimit të saj shtrihet në:

- të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

- godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t'i nënshtrohen rikonstruksionit;

- ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes;

- ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik.

Neni 2

Përshtatja e objekteve ekzistuese

1. Në ndërtesat dhe hapësirat publike ekzistuese, edhe pse nuk janë objekt ristrukturimi ose riorganizimi funksional, duhet të evidentohen dhe te llogariten të gjitha mundësitë për përshtatje, të cilat mund të përmirësojnë shfrytëzimin në bazë të kërkesave që janë në këtë rregullore.

2. Çdo ndërtesë duhet të pajiset, nën kujdesin e administratorit publik apo privat të ndërtesës, me një sistem thirrjesh që të aktivizojë një shërbim ndihme në mënyrë të tillë që t'u lejojë personave me aftësi të kufizuara lëvizjen ose ndijimin e shërbimit me zë.

3. Në objektet e banimit publike/private dhe në banesa vetjake, përfshi edhe ato të hapura për publikun, aplikohen rregullat dhe standardet e përcaktuara në këtë rregullore.

4. Nuk mund të ofrohen kontribute ose lehtësime nga ana e shtetit dhe e enteve të tjera publike për realizimin e punimeve publike ose të shërbimeve publike në kundërshtim me këto rregulla dhe standarde.

Neni 3

.....

4. Ky vendim e shtrin zbatimin mbi: a) bashkitë dhe strukturat e tyre të kontrollit, sipërmarrësit

privatë, administratorët e bizneseve, kompanitë e projektimit e të zbatimit për të garantuar një mjedis pa pengesa për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara; b) të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kryesisht objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, objektet kulturore, objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët; c) mjetet e transportit publik; ç) mediat dhe tërësinë e mjeteve publike apo private të informimit publik.

5. Standardet e përshtatshmërisë zbatohen në të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore ekzistuese si dhe në parqet, sheshet e rrugët ekzistuese, bazuar në kërkesat e parashikuara në kreun II, të këtij vendimi.

.....

8. "Eliminimi i barrierave - është rezultat i aplikimit të zgjedhjes teknike në projektim dhe ndërtim të objektit me të cilat PAK-ja siguron lëvizjen pa pengesë, qëndrimin dhe kryerjen e punëve në to në të njëjtin nivel sikurse personat e tjerë.

9. Elementet e eliminimit të barrierave - janë pjesë të objekteve ndërtimor ose pajisje, të cilat sigurojnë eliminimin e barrierave, të përcaktuara me këtë rregullore. Këto elemente ose pajisje janë: rampa, shkallë, ashensor, platforma vertikale ngritëse, platforma të pjerrëta lëvizëse palosëse, detaje në hapësirat hyrëse, doreza e derës dhe dritares, pulti, tabela e shpalljeve, plani orientues për lëvizje në ndërtesë, semafori, pajisje komunikimi, hapësira dhe pajisje ËC, banja, kuzhine, dhoma, klasa, ambiente pune, banimi/apartamenti, kafeneja, restoranti, gardëroba, kabina dushi, pishina, vendet në tribuna, kabina telefonike, tekstofoni, bankomati, instalimet elektrike, stacioni dhe peroni, vend parkingu, sipërfaqja publike për këmbësor, kalimi për këmbësor, ishulli për këmbësorë dhe udhëkryqi.

10. Elementet e detyrueshëm për eliminimin e barrierave - janë elementet për projektim dhe ndërtim me anë të të cilave përcaktohet madhësia, vetitë, instalimet dhe pajisjet e tjera të

ndërtesës për sigurimin e eliminimit të pengesave në lëvizje, qëndrim dhe punë të PAK-së, në të njëjtin nivel me personat tjerë.

11. Shenjat dalluese - janë shenjat me të cilat përcaktohen elementet detyruese për përshtatje.

.....

13. Lajmërimi me sinjalizime të dritës - është lajmërimi dhe paralajmërimi për personat që nuk dëgjojnë dhe ata me dëgjim të dobët me ndihmën e sinjalizimit të dritës.

14. Lajmërimi zanor - është lajmërimi dhe paralajmërimi nëpërmjet zërit për personat që nuk shohin dhe/ose kanë shikim të dobët.

15. Sinjalizimi zanor - është sinjalizimi i cili ndihmon personat që nuk shohin dhe/ose me shikim të dobësuar për orientim në hapësirë.

19. Përpunimi relievor - është përpunimi përfundimtar me reliev i sipërfaqes së ecjes.

20. Vija relievore drejtuese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes e dedikuar për drejtim të lëvizjes së personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar, e cila në fund të rrugës dhe në vendin e ndërrimit të drejtimit të lëvizjes përcakton atë me ndërrimin e strukturës relievore me gjerësi së paku 40 cm.

21. Vija relievore paralajmëruese - është përpunim me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila vendoset me qëllim të paralajmërimit të personave që nuk shohin dhe/ose me shikim të dobësuar për rrezikun nga komunikacioni.

22. Fusha relievore paralajmëruese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila shërben për paralajmërim të personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar të ndryshimit të nivelit të lëvizjes.

....

25. Sipërfaqe me reliev e kalimit - është shenjë relievore e cila personave që nuk shohin dhe/ose me shikim të dobësuar iu afron informacion për gjatësinë dhe llojin e kalimit të këmbësoreve përtej kalimit të automjeteve.”

Referuar parashikimeve të mësipërme të bëra në VKM nr. 1503/2008, ekzistojnë rregulla dhe standarde të mirëpërcaktuara teknike dhe të detyrueshme për zbatim, të cilat duhet të përmbushen, sikurse është në rastin objekt shqyrtimi, ishulli i kalimit në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi e provuar se se ishulli i kalimit në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, nuk është konform standardeve teknike dhe ligjore të aksesueshmërisë për PAK. Ishulli i kalimit të këmbësorëve është në formë gunge dhe jo plotësisht i sheshtë, nuk ka shirita me reliev për personat që nuk shikojnë. Gjithashtu semafori i vendosur nuk është akustik, që t’u shërbente kësaj kategorie personash. Për rrjedhojë shërbimi i ofruar krijon pamundësi apo vështirësi që të aksesohet dhe të përdoret nga personat me aftësi të kufizuar që janë përdorues të karrocës me rrota apo duke paraqitur vështirësi ose pamundësi edhe për personat me aftësi të kufizuar, të cilët pavarësisht

se nuk janë përdorues të karrocës me rrota, kanë vështirësi në lëvizje, personat që nuk shikojnë apo personat që nuk dëgjojnë.

Pavarësisht qendrimit dhe gadishmërisë së treguar nga përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë që të merrnin masa për të deleguar e bashkëpunuar me strukturat përgjegjëse pranë Bashkisë Tiranë, të cilat kishin dhe tagrin për menaxhimin e zgjidhjen e problematikës së ngritur nga ana e Fondacionit, Bashkia nuk arriti të tregojë se kishte hartuar një plan masash, me afate konkrete se kur do të realizohej një ndërhyrje e tillë, në përputhje me kriteret teknike të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi.

Bazuar në konstatimet e mësipërme si dhe referuar standardeve dhe kriterëve teknike të parashikuara nga VKM nr. 1074/2015 dhe VKM nr. 1503/2008, për ishujt e këmbësorëve e semaforët e kalimit të rrugës, ishulli i kalimit në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë nuk plotëson kushtet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, sikurse më sipër rezulton, kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM-të respektive. Është respektimi i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike, në tërësinë e tyre, që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses në shërbime e infrastrukturë në baza të barabarta me të tjerët. Ekzistenca e pengesave/barrierave infrastrukturore në ishullin e kalimit në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t’u mohohet akses sipas standardeve dhe kriterëve tekniko-ligjore.

Në bazë të nenit 23, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, përcaktohen funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore, në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, duke parashikuar shprehimisht në pikën 4, të këtij neni, se :

“Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: 4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.”

Rregullorja “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të institucionit të Bashkisë së Tiranës⁹”, ka për objekt krijimin e një kuadri rregullator për funksionimin me efikasitet dhe efikasitet të veprimtarisë së administratës së Bashkisë së

⁹Miratuar me Vendimin nr. 22258, datë 14.06.2022 për “Miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të institucionit të Bashkisë së Tiranës”, të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës.

Tiranës, për realizimin e funksioneve dhe kompetencave të saj, të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë¹⁰.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të qëndrueshme, mbi të cilat do të ndërtohen marrëdhëniet ndërmjet niveleve të ndryshme hierarkike të aparatit të Bashkisë së Tiranës dhe institucioneve të varësisë së saj, për një veprimtari me efikasitet dhe transparente të administratës ndaj publikut, si dhe për t'i shërbyer sa më mirë këtij të fundit.

Në nenin 5, të kësaj Rregulloreje përcaktohen, parimet mbi të cilat bazohet administrata e Bashkisë Tiranë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, ndër të cilat:

“Parimi qartësisë: në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë, ndarja, caktimi i funksioneve dhe detyrave administrative, ndërmjet organeve, institucioneve dhe njësisë administrative, duhet të jenë specifike, të shmangin mbivendosjen, të jenë transparente dhe të jenë publike dhe lehtësisht të kuptueshme.

Parimi ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit: caktimi dhe shpërndarja e përgjegjësisë, si dhe organizimi i administratës të Bashkisë Tiranë, nëpërmjet së cilët të sigurohet efektivitet në kryerjen e funksioneve dhe detyrave, efikasitetin në arritjen e objektivave të politikave të miratuara, si dhe ekonominë në përdorimin e të mirave dhe fondeve publike.

Parimi bashkëpunimit: strukturat pjesë e Aparatit të Institucionit dhe vartëse, në të gjitha nivelet e administratës të pushtetit vendor, duhet të bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucioneve të pavarura, për arritjen e objektivave ligjore të cilëve i'u është besuar, në përputhje me ligjin”.

Në nenin 45, të Rregullores është përcaktuar misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, duke cilësuar se:

“Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike planifikon dhe menaxhon çështje që lidhen me realizimin e punëve publike për komunitetin në funksion të planifikimit të shërbimeve të infrastrukturës, menaxhimit dhe trajtimit të mbetjeve, transportit dhe shërbimeve të ofruara nga ndërmarrjet e qendrat sociale kulturore, monitoron dhe mbikqyr veprimtarinë e agjencive, ndërmarrjeve, qendrave ekonomike, sociale dhe kulturore.

Detyrat e kësaj Drejtorie janë:

- 1. Propozon miratimin e projekteve të shërbimeve publike, infrastrukturës rrugore, arsimit, strehimit dhe shërbimit social;*
- 2. Siguron zhvillimin dhe përmirësimin e rrjetit rrugor, duke zbatuar planet e miratuara;*
- 3. Zbaton master planin e transportit të projektimit për rrjetin rrugor, në kuadrin e zhvillimit urban të qytetit, realizohet klasifikimi rrjetit rrugor, shpërndarja për çdo përdorues, duke projektuar rrjetin rrugor, të gjitha shenjat e trafikut si dhe teknologjitë e destinuar për rregullimin e trafikut, në përputhje me plotësimin e nevojave për lëvizshmëri;*

¹⁰ Neni 1, i Rregullores.

4. Monitoron dhe vlerëson shërbimet e ofruara nga agjencitë dhe ndërmarrjet në varësi të Bashkisë Tiranë, për ofrimin e një shërbimi sa më cilësor ndaj qytetarëve si dhe përdorimin në mënyrë eficiente, efektive të burimeve financiare dhe njerëzore që ato disponojnë;
5. Monitoron planin rregullues të trafikut, vendkalimet dhe parkimet, me anë të aktiviteteve të monitorimit dhe vrojtimit të analizave të studimit”.

Neni 45.4.2 i Rregullores ka përcaktuar misionin dhe detyrat e Sektorit të Investimeve në Infrastrukturën Rrugore, pranë Bashkisë:

“Sektori i Investimeve në Infrastrukturën Rrugore administron çështje që lidhen me sigurimin e realizimit të investimeve në infrastrukturën rrugore në afatet e përcaktuara në kontratë, konform kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit, sipas projekteve të miratuara nëpërmjet monitorimit rigoroz dhe të vazhdueshëm, me qëllim arritjen e objektivave dhe përmbushjen e rezultateve të kërkuara nga kjo njësi organizative nëpërmjet përdorimit eficient të burimeve financiare dhe njerëzore në dispozicion.

Detyrat e tij janë:

1. Merr pjesë në diskutimet dhe grupet e punës për hartimin e detyrave të projektimit, planeve buxhetore afatmesëm në fushën e investimeve për objektet e infrastrukturës rrugore dhe më pas renditen në tabelën e buxhetit të miratuar nga Keshilli Bashkiak, konkretisht në kapitullin e programit të menaxhimit të rrugëve dhe transportit;
2. Verifikon dhe administron kontratat e sipërmarrjes dhe mbikëqyrjes së punimeve, ofertën dhe grafikun e punimeve të përcjella nga Drejtoria e Prokurimeve për objektet e infrastrukturës rrugore;
3. Administron dosjen teknike (projektin e zbatimit, relacionin dhe specifikimet teknike, azhornimet UKT, KUZ, OSHEE, Albtelekom) nga Drejtoria e Planifikimit të Punëve Publike sipas kontratave të Drejtorisë së Prokurimeve, për objektet e infrastrukturës rrugore;
4. Vendos në dispozicion të Sipërmarrësit dhe Mbikëqyrësit të punimeve, pas marrjes së dokumentacionit teknik (projektit të zbatimit, relacioni dhe specifikimet teknike, azhornimet UKT, KUZ, OSHEE, Albtelekom etj.) nga Drejtoria e Planifikimit të Punëve Publike;
5. Verifikon ekzekutimin e kontratave dhe zbatimin e investimeve për objektet e infrastrukturës rrugore në mënyrë që të realizohen në kohë, brenda buxhetit të miratuar dhe me cilësinë e parashikuar në kushtet e kontratës;
6. Identifikon ndryshimet që kërkohen gjatë zbatimit të projekteve në objektet e infrastrukturës rrugore, e në rast konstatimi të ndryshimeve thelbësore dhe teknike të projekteve që ndodhin gjatë zbatimit, përgatit dosjen përkatëse dhe e depoziton në Drejtorinë e Planifikimit të Punëve Publike, për t’u diskutuar dhe miratuar në Këshillin Teknik;
7. Administron kontratat e infrastrukturës rrugore, duke përfshirë raportimin periodik, teknik dhe financiar mbi ecurinë e zbatimit, problematikat dhe realizimin e tyre;
8. Verifikon e kontrollon punën e kontraktorëve (sipërmarrës, mbikëqyrës, kolaudator), si dhe propozon masa konform ligjit dhe kontratës, në rastet kur vëren shkelje të kontratës dhe kushteve të saj për objektet e infrastrukturës rrugore;

9. Përgatit dokumentacionin dhe procedurat për emërimin e kolaudatorëve të objekteve, kontrollojnë afatet e përfundimit të punimeve (duke informuar një muaj përpara përfundimit të punimeve të parashikuar në kontratë) dhe siguron dorëzimin në afat të dosjes së mbikqyrësit të punimeve në përfundim të punimeve të objektit në përputhje me legjislacionin në fuqi për të gjitha objektet e infrastrukturës rrugore;

10. Realizon kontrollin e gjendjes së punimeve në objektet e infrastrukturës rrugore që janë në periudhën e garancisë nëpërmjet kontrolleve periodike të planifikuara, si dhe harton relacionet përkatëse për difektet e konstatuara e propozon afatin e kryerjes së riparimeve të nevojshme, duke siguruar zgjidhje të problemeve të evidentuara sipas kushteve të kontratës;

11. Ndjek dhe verifikon procedurën për plotësimin e dokumentacionit të dosjes së objekteve të infrastrukturës rrugore, arkivimin e tyre pas përfundimit të periudhës së garancisë dhe i paraqet drejtorive përkatëse kërkesat për kalimin e objekteve në fondet themelore të ndërmarrjeve;

12. Përgatit vlerësimet dhe referencat e ndryshme për punimet që kanë kryer kompanitë ndërtuese, mbikqyrësit dhe kolaudatorët e punimeve përinfrastukturën Rrugore”.

Neni 45.5.5 i Rregullores “Sektori i Sigurisë dhe Sinjalistikës Rrugore” përcakton se:

Sektori i Sigurisë dhe Sinjalistikës Rrugore administron çështje që lidhen me sigurinë, krijimin dhe përmirësimin e sistemit të sigurisë rrugore në harmoni me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, me qëllim arritjen e objektivave dhe përmbushjen e rezultateve të kërkuara nga kjo njësi organizative nëpërmjet përdorimit eficient të burimeve financiare dhe njerëzore në dispozicion.

Detyrat e tij janë:

1. Siguron përputhshmërinë me standardet e sigurisë rrugore, e studimeve e projekteve që do të kryhen në territorin administrativ të Bashkisë Tiranë, si në rrjetin rrugor, ashtu dhe në shenjat e trafikut, impiantet semaforike, shenjëzimet vertikale, horizontale ashtu si dhe impiante të tjerë teknologjikë të destinuar për disiplinimin dhe sigurinë e trafikut;

2. Siguron pasqyrimin në një kohë reale të informacionit, për indikatorët bazë të vlerësimit të sigurisë rrugore, përfshirë këtu mbledhjen e të dhënave për askidentet rrugore, (vdekjet, plagosjet, dëmtimet ndaj pronës), si indikatorë kryesorë dhe pasqyrimi i tyre për të bërë vlerësimin e projekteve në vazhdim;

3. Organizon punën për ndjekjen e aktiviteteteve “ditë pas dite”, duke u mbështetur në ndryshimin dhe përditësimin e disiplinës së trafikut në përputhje me kërkesat e përkohshme/ose të përhershme të mobilitetit në rrugë;

4. Organizon aktivitete në përputhje me realizimin e objektivave që lidhen me studimin e programeve dhe projekteve të zhvillimit afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër”.

Bashkia është një entitet që ekziston e funksionon si një tërësi organizmesh e strukturash të veçanta të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën në funksion të saj. Në këtë kuadër, për realizimin e saktë të funksioneve dhe përgjegjësisë të Bashkisë së Tiranës, të gjitha strukturat

e administratës së Bashkisë, drejtori apo sektorë të veçantë të saj, ndërveprojnë dhe bashkëpunojnë me njëri tjetrin, *për* dhe *në* emër të Bashkisë.

Sa më sipër, rezulton se, (pavarësisht detyrave e përgjegjësisve specifike të sektorëve apo drejtorive të veçanta brenda entitetit të Bashkisë) është në përgjegjësinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore, Bashkisë së Tiranës në rastin në fjalë, që të sigurojë aksesueshmërinë në ishullin e kalimit në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, i cili është në juridiksionin e saj territorial, konform standardeve teknike e ligjore në aktet përkatëse.

Rrjedhimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, është në përgjegjësinë e Bashkisë Tiranë, si njësi e vetëqeverisjes vendore në juridiksionin e të cilës është ishulli i kalimit të këmbësorëve e semafori në fjalë, të sigurojë aksesueshmërinë e tij.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, ishulli i këmbësorëve e semafori pranë të ashtëquajturës “Kupola”/Tiranë, nuk përmbush standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar, e për rrjedhojë Bashkia nuk ka përmbushur detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar. Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuar të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm në raport me personat e tjerë që nuk janë me aftësi të kufizuar.

B. Shkaku i mbrojtur

Pala ankuese pretendon diskriminim të personave me aftësi të kufizuar në ishullin e kalimit të këmbësorëve e semaforin e tij, në të ashtëquajturën “Kupola”, në rrugën “Dritan Hoxha”, Tiranë, për shkak të mungesës së aksesueshmërisë.

Në nenin 1, të LMD, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Referuar nenit 1, të LMD, shkaku i diskriminimit “*aftësia e kufizuar*” i pretenduar nga pala ankuese, konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë shkakun e mbrojtur.

Kushtetuta është akti më i lartë juridik, ligji më i lartë (lex superior), në pajtueshmëri me të cilin duhet të jenë të gjitha aktet e tjera juridike.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshton të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”*. Neni 18, i saj shpreh se: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”*.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se:

“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllëjta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë.” (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

Në nenin 59, shkronjat e) dhe f) të saj, Kushtetuta ka parshikuar se:

“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;

f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës”.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material.

Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor¹¹¹.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (*e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”*) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “*gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji*” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: “*a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik*”.

¹¹¹ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet¹². Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme¹³. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme¹⁴. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14, nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar "pabarazitë faktike" ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14¹⁵.

Shqipëria e ratifikoi Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, në Dhjetor të vitit 2012 dhe është bërë Palë në të, që prej 11 Shkurtit 2013.

Kjo Konventë, në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se:

"Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar."

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK), ka për qëllim të nxisë, mbrojë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

Në kuptimin të kësaj Konvente: *"Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar"* ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore,

¹² Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

¹³ Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹⁴ Shih: *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹⁵ Shih: *Çështjen Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; *Çështjen Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; *Çështjen D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës”.

Parimet e kësaj Konvente përfshijnë:

- “(a) Respektin për dinjitetin, autonominë individuale përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit;*
- (b) Mosdiskriminimin;*
- (c) Pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri;*
- (d) Respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit;*
- (e) Mundësi të barabarta;*
- (f) Akses; ...”*

Neni 5 i Konventës, ka përcaktuar se:

- “1. Shtetet Palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.*
- 2. Shtetet Palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimii për shkak të aftësisë së kufizuar dhe t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në cdo rrethanë.*
- 3. Me qëllim nxitjen e barazisë dhe eliminimin e diskriminimit, Shtetet Palë duhet të ndër marrin të gjitha hapat e duhura për tu siguruar se është ofruar akomodim i arsyeshëm.*
- 4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur de facto barazinë e personave me aftësi të kufizuara nuk do të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj Konvente.”*

KDPAK parashikon në nenin 9, të saj, të drejtën për aksesueshmëri si një të drejtë më vete, përpos parashikimit të aksesueshmërisë si një nga parimet mbi bazën e të cilit duhet të interpretohen të gjithë të drejtat e tjera për personat me aftësi të kufizuara. Neni 9, i KDPAK vendos mbi shtetet detyrimin për të marrë masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët.

Në nenin 29, shkronjën a), të Konventës, përcaktohet se:

“Shtetet Palë duhet t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t’i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullësisë dhe duhet të marrin përsipër: a) T’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët....”.

Për të siguruar këtë të drejtë, KDPAK, ngarkon shtetet me disa detyrime, ndër të tjera, për të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara gëzojnë akses në institucionet apo shërbimet e ofruara për publikun.

KDPAK përfaqëson standartin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni 1).

Për një kohë të gjatë, personat me aftësi të kufizuara janë parë më shumë si objekte se sa si subjekte të së drejtës, duke evidentuar dhe theksuar paaftësinë/të. Ndërkohë, qasja e re që ofron Konventa “*Për të drejtat e personave e aftësi të kufizuara*” bazohet jo më në modelin e “*bamirësisë*”, por në atë të të drejtave të njeriut, ku personat me aftësi të kufizuar, si të gjithë qeniet njerëzore, i zotërojnë të drejtat e tyre në mënyrë të pakushtëzuar.

Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambjentit që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët.

Në qendër të vëmendjes nuk është paaftësia e mundshme, por barrierat që vendos shteti apo shoqëria, duke penguar gëzimin e tyre. Barrierat janë të shumëllojshme, ku përveç barrierave fizike, barrierat e ndryshme shoqërore të bazuara në stereotipe, çojnë drejt përjashtimit të personave me aftësi të kufizuara dhe potencialisht mbështesin këtë përjashtim.

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga Konventa si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*” (në vijim ligji nr. 93/2014). Në nenin 3, pika 9, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se:

“9. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.”

Në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet: “*Aksesueshmëri*” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se:

“ 3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.”

Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimi të pengesave të të gjitha llojeve është një nga parimet e këtij ligji (neni 3/ç) dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuar mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, përfshirë aksesin në të gjitha shërbimet publike.

Ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, është një ligj i cili është miratuar në bazë dhe në zbatim të nenit 18, të Kushtetutës. Në bazë të LMD, jo çdo diferencë në trajtim, konsiderohet diskriminim. Neni 6, i LMD, përcakton: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD, *“Diskriminimi”* përkufizohet si: *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Në pikën 1, të nenit 5, të LMD, sanksionohet ndalimi i diskriminimit, sipas formulimit vijues: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.”*

Në Kreun IV, të LMD, parashikohet një mbrojtje të posaçme nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Konkretisht, në nenin 20, pika 1, dhe pika 2, shkronjat *“a”* dhe *“ë”*, të LMD parashikohet:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi. 2. Pika 1 e këtij neni

zbatohet veçanërisht për: a) mundësi për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t'u përdorur nga publiku; ”

Barra e provës në çështjet e diskriminimit, është objekt i rregullimit të veçantë sipas LMD. Bazuar në nenin 33 pika 7/1, të LMD, sanksionohet se:

“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Të njëjtin rregullim, në lidhje me barrën e provës parashikohet edhe nga Kodi i Procedurave Administrative. Konkretisht, në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se:

“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminim, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminim.¹⁶

Bazuar në faktet dhe provat e administruara, si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se, ishulli i kalimit në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë dhe semafori i tij , nuk përmbushin standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, personat me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk

¹⁶ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

kanë aftësi të kufizuar dhe nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuar.

Sa më sipër, rezulton plotësisht e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur, që në rastin konkret është aftësia e kufizuar, dhe trajtimit të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i janë nënshkruar personat me aftësi të kufizuar, për shkak të mosrespektimit të standardeve të aksesueshmërisë, të miratuar nga aktet në fuqi si më sipër janë cituar.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet se ka patur diskriminim, pra të diskriminimit *prima facie*. Rrjedhimisht, bazuar në standardin e provës, Bashkia Tiranë kishte barrën e provës që të provonte se, trajtimi i pabarabartë dhe më pak i favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuar për shkak të mungesës së aksesueshmërisë në ishullin e kalimit e semaforin sipërcituar, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Aksesueshmëria është një parakusht për gëzimin efektiv të të drejtave të ndryshme nga personat me aftësi të kufizuara, përfshi edhe të drejtën për të mirat dhe shërbime. Megjithatë sipas KDPAK, sigurimi i aksesueshmërisë arrihet përmes realizimit progresiv.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, parashikohet se:

“E drejta për aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara sigurohet përmes zbatimit të rreptë të standardeve të aksesueshmërisë. Pengesat për të hyrë në objektet ekzistuese, ambientet, mallrat dhe shërbimet e synuara ose të hapura për publikun duhet të hiqen gradualisht në një mënyrë sistematike dhe, më e rëndësishmja, të monitoruar vazhdimisht, me qëllim që të sigurohet aksesueshmëria e plotë”.

Kjo qasje parashikohet edhe në nenin 4, të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në bazë të të cilit është miratuar VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Në këtë VKM, parashikohet se planifikimi për realizimin e përshtatjes, nga ana e subjekteve të detyruara, do të realizohet në mënyrë progresive (Kreu I, pika 12).

Sipas pikës 10, të Kreut I, të VKM-së nr.1074, datë 23.12.2015, parashikohet gjithashtu se:

“Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë.”

VKM nr. 1074/2015 vijon më tej duke parashikuar në pikat 9, 10, 13 dhe 14 të tij se:

“9. Çdo subjekt, që ofron shërbime për publikun, është i detyruar që të miratojë një plan masash për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja e tij në

fuqi. 10. Në planin e masave përfaqësohet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë. 13. Çdo subjekt, sipas pikës 4, të këtij vendimi, ka detyrimin që, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e miratimit të planit të masave, të fillojë punën për të realizuar procesin e përshtatshmërisë lidhur me objektet ekzistuese dhe shërbimet e ofruara.”

Realizimi progresiv do të thotë që heqja e pengesave dhe sigurimi i aksesueshmërisë duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme.

Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, i miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, përcakton se:

“Si minimum, situatat e mëposhtme në të cilat mungesa e aksesit ka penguar një person me aftësi të kufizuara të ketë akses në një shërbim ose objekt të hapur për publikun, duhet të konsiderohen si akte të ndaluara të diskriminimit të bazuar në aftësinë e kufizuar: (a) Kur shërbimi ose objekti është krijuar pasi janë prezantuar standardet përkatëse të aksesueshmërisë; (b) Aty ku akses mund të ishte dhënë në objekt ose shërbim (kur ai u krijua) nëpërmjet përshtatjes së arsyeshme.....”.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t’u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, si dhe mundësisht t’u garantohet jetesa e pavarur.

Në kushtet kur shteti, krijon lehtësira të caktuara përmes parashikimeve specifike në akte ligjore apo nënligjore të tij, për kategoritë përfituese të individëve, (përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuara) duhet të sigurohet që t’i ofrojë këto shërbime pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025¹⁷, citon ndër të tjera se:

“Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) 2021-2025, është një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara e që do të hidhen për zbatim gjatë 5 vjeçarit të ardhshëm. Qëllimi i tij është të vazhdojë promovimin dhe mbështetjen e integritetit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social-ekonomike të vendit duke patur në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve të KDPAK përmes masave specifike.

Procesi i hartimit të këtij dokumenti përputhet edhe me një moment tjetër të rëndësishëm të zbatimit të politikave për aftësinë e kufizuar në Shqipëri në funksion të realizimit të parimeve të KDPAK, të ratifikuar nga shteti shqiptar.

¹⁷ Miratuar me VKM Nr. 276, datë 12.05.2021

Qëllimi, objektivat specifike dhe masat e parashikuara në këtë plan për realizimin e aksesueshmërisë, adresojnë reduktimin e barrierave për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim: (i) sigurimin e aksesit në të mirat materiale, shërbimet dhe lehtësirat; (ii) sigurimin dhe mbajtjen e vendit të punës; (iii) përfshirjen dhe pjesëmarrjen në komunitet; (iv) ndryshimet në sjelljet, qëndrimet dhe veprimet, të cilat diskriminojnë personat me aftësi të kufizuara.

Politika orienton institucionet publike në masat që ato duhet të marrin për realizimin e aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në: (i) mjedise; (ii) transport; (iii) informacion e komunikim”.

Ky dokument thekson faktin se, qeveria është e angazhuar të administrojë në mënyrë aktive çështjen e aftësisë së kufizuar në Shqipëri duke përditësuar gjithmonë e më shumë të drejtat e PAK në politikat e saj sektoriale.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Tiranë, nuk vendosi në dispozicion asnjë informacion në lidhje me masat konkrete, afatet kohore dhe fondet, (apo hartimin e një plani konkret të mirëfilltë) për të rikonsideruar ndërhyrjen a përmirësimin e situatës teknike, në ishullin e semaforin ekzistues në kalimin e këmbësorëve në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, në përputhje me standardet dhe kriteret teknike në fuqi. Komisioneri vlerëson se, nga ana e Bashkisë nuk janë marrë masa për të punuar drejt realizimit gradual dhe as të menjëhershëm, të përmbushjes së standardeve të kërkuara të aksesueshmërisë.

Duke mbajtur në konsideratë gjithë sa më sipër, Komisioneri konstaton se, Bashkia Tiranë, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave infrastrukture/arkitektonike dhe sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar në ishullin e këmbësorëve dhe semaforin e tij, në vendndodhjen e ashtëquajtur si “Kupola” Tiranë.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parashikohet se:

“.....25. Aksesueshmëria lidhet me grupet, ndërsa përshtatja e arsyeshme lidhet me individët. Kjo do të thotë se detyra për të ofruar akses është një detyrë ex ante. Prandaj, shtetet palë kanë për detyrë të ofrojnë aksesueshmërinë përpara se të marrin kërkesa individuale për të hyrë ose përdorur një vend ose shërbim..... Standardet e aksesueshmërisë duhet të jenë të gjera dhe të standardizuara..... Në përputhje me Konventën, shtetet palë nuk lejohen të përdorin masat shtrënguese si justifikim për të shmangur sigurimin e aksesueshmërisë graduale për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për të zbatuar aksesueshmërinë është i pakushtëzuar, pra subjekti i detyruar që të sigurojë aksesueshmërinë nuk mund të justifikojë mosveprimin për t’a siguruar atë, duke iu referuar barrës për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për

përshtatjen e arsyeshme, përkundrazi, ekziston vetëm nëse zbatimi nuk përbën barrë të tepruar për subjektin.

26. Detyra për të ofruar përshtatje të arsyeshëm është një detyrë ex nunc, që do të thotë se është e detyrueshme që nga momenti kur një individ me dëmtim ka nevojë për të në një situatë të caktuar..... Këtu, standardet e aksesueshmërisë mund të jenë një tregues, por mund të mos merren si urdhërues. Përshtatja e arsyeshme mund të përdoret si një mjet për të siguruar akses për një person me aftësi të kufizuara në një situatë të caktuar.....”.

GJEDNJ në jurisprudencën e saj, lidhur me diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara, ka mbajtur qëndrimin se:

“...duke pasur parasysh nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të nxitur pjesëmarrjen dhe integritetin e tyre të plotë në shoqëri, marzhi i vlerësimit që gëzojnë shtetet në vendosjen e trajtimit të ndryshëm ligjor për personat me aftësi të kufizuara është ndjeshëm i reduktuar¹⁸ dhe se për shkak të cenueshmërisë së veçantë të personave me aftësi të kufizuara, një trajtim i tillë do të kërkonte arsye shumë të rëndësishme për t’u justifikuar¹⁹.”

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në ishullin e semaforit ekzistues në kalimin e këmbësorëve në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, dhe se Bashkia Tiranë nuk arriti të provojë se ka marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë për PAK.

Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara si pasojë e mungesës së aksesueshmërisë së ishullit të semaforit ekzistues në kalimin e këmbësorëve në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se:

“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të LMD, përcaktohet:

“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

¹⁸ Shih: *Glor kundër Zvicrës*, nr.13444/04, prg. 84, GJEDNJ 2009.

¹⁹ Shih: *Guberina kundër Kroacisë*, nr. 23682/13, 73, GJEDNJ 2016.

LMD, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. LMD, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuar, pasi rezultoi se Bashkia Tiranë nuk ka marrë masa për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar në ishullin e semaforin e kalimit të këmbësorëve në kryqëzimin e rrugës “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit dhe garantimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, sipas standardeve të miratuara dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar nga ana e Bashkisë së Tiranës, për shkak të mungesës së aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në ishullin e semaforin e kalimit të këmbësorëve në kryqëzimin e rrugës “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë.
2. Bashkia e Tiranës, të marrë masa konkrete për të siguruar në mënyrë efektive, aksesueshmërinë në ishullin e kalimit të këmbësorëve në kryqëzimin e rrugës “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, në përputhje me standardet ligjore në fuqi dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Bashkia e Tiranës, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.

5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: AK
Lloji i vendimit: Diskriminim